

THIRRJE PUBLIKE

PËR KANDIDIM TË GJYQTARËVE NË SKEMËN E DELEGIMIT

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në nenin 45 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenet 6 e vijues të “Rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, i ndryshuar, të miratuar me vendimin e tij nr.22, datë 07.02.2019, drejton këtë thirrje publike për kandidim të gjyqtarëve në skemën e delegimit:

1. Gjyqtarët mund të shprehin interesin për t’u komanduar në skemën e delegimit duke kandiduar **në çdo kohë**. Në kushtet kur gjyqtari që kandidon në këtë skemë, shfaq interes për komandim edhe pranë gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar duhet të japë pëlqimin për rishikimin periodik të llogarive financiare dhe telekomunikimeve vetjake, për vete dhe për të afërmit e tij, sipas përcaktimeve në Ligjin nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.
2. Gjyqtari që kandidon paraqet dokumentacionin pranë Komisionit të Zhvillimit të Karrierës në Këshill, me anë të postës, postës elektronike ose dorazi. Dokumentacioni regjistrohet dhe administrohet nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Sa më sipër, për më tepër informacion, konsultohuni me ligjet e sipërcituara si dhe me “Rregulloren për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit” të miratuar me vendimin nr.22, datë 07.02.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, që gjendet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR